REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 120/17
Datë/Datum. 21.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: *Policia e Kosovës*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *214/16/134/111*

Sa i përket tenderit për *Furnizim me jelek anti - plumb*

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

*Polioni i Shenjëtarisë "Katana" sh.p.k.*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*rr. "Hasan Prishtina" 360*
*(Adresa)*
*Obiliq* — *15000*
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*
*038/560-215* — *038/560-215*
*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

*Agron Jusufi*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
*poligoni-katana@hotmail.com*
*(Adresa elektronike)*

*21/04/2017*
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

KATANA 1 POLIGONI I SHENJËTARISË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

*Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës, ka publikuar Njoftimin për Kontratë më 27/06/2016. Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë më 29/07/2016. Hapja e tenderëve është kryer sipas procedurave të përcaktuara dhe nuk ka pasur vërejtje.*
*Njoftimi për dhënie të kontratës në faqe të KRPP-së është publikuar më 12/08/2016 kurse Letrën Standarde si tenderues i pasuksesshëm, kemi pranuar më 15/08/2016. Të njëjtën ditë e kemi dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentacionin e tenderit.*
*Nga AK jemi fituar për të shikuar dosjet e tenderit më datën 16/08/2016. me ç'rast kemi pranuar edhe kopjen e një pjese të dosjes së tenderit fitues, sipas përcaktimit nga ana jonë. Kopjen e një pjese të dosjes së tenderit të kompanisë Sodex sh.p.k. sipas përcaktimit nga ana jonë, e kemi pranuar më 17/08/2016.*
*Më 19/08/2016. jemi njoftuar nga AK se, meqenëse njoftimin standard si tenderues i pasuksesshëm e kemi pranuar më 15/08/2016, ndërs dita e pestë i bie e shtunë, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit është data 22/08/2016.*
*Më 19/08/2016. kemi pranuar njoftimin nga AK për pezullimin e kësaj procedure të prokurimit.*
*Më 25/08/2016. kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës së parashtruar për rishqyrtim.*
*Më 11/11/2016. OSHP ka lëshuar vendim me nr. reference PSH 294-297/16 në të cilin kërkohet që AK të bëjë rivlerësimin e ofertave, duke u trajtuar të gjithë ofertuesit në mënyrë të barabartë, konform Nenit 7. të LPP-së.*
*Më 15/11/2016. nga AK është kërkuar që të vazhdojmë validitetin e ofertës për një periudhë prej 60 ditëve*
*Më 22/11/2016. nga AK është kërkuar që të vazdhojmë sigurimin e tenderit edhe për një periudhë prej 30 ditëve*
*Më 21/12/2016. nga AK është kërkuar që të vazdhojmë validitetin e ofertës për një*

*periudhë prej 60 ditëve, si dhe sigurimin e tenderit për një periudhë prej 90 ditëve*
*Më 20/02/2017. nga AK është kërkuar që të vazdhojmë validitetin e ofertës për një periudhë prej 90 ditëve*
*Më 23/03/2017. nga AK është kërkuar që të vazhdojmë sigurimin e tenderit për një periudhë prej 120 ditëve.*
*Më 31/03/2017. nga AK kemi pranuar "Letër standarde për tenderuesin e pasuksseshëm".*
*Më 03/04/2017. kemi dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentacionin e tenderit fitues dhe na është lejuar qasja në dokumentacion.*
*Më 05/04/2017. kemi dorëzuar parashtresën për rishqyrtim të vendimit në AK*
*Më 14/04/2017. kemi pranuar vendimin nga AK për refuzim të ankesës.*
*Kriter për dhënien e kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm, me çmimin më të ultë*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [X] **Jo** [ ]

*Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë më 29/07/2016.*
*Janë dorëzuar gjashtë (6) oferta. Të pranishëm në hapje të tenderëve kanë qenë përfaqësuesit e kompanive: Iliria-2 SHPK; NTSH Lenti; Reload; Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" sh.p.k.; All Zone; dhe Sodex group sh.p.k.*
*Hapja e tenderëve është kryer sipas procedurave të përcaktuara dhe nuk ka pasur vërejtje.*

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [ ] **Jo** [X]

Më 31/03/2017. kemi pranuar njoftimin standard për tenderuesin e pasuksseshëm

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

Pas kërkesës sonë, nga AK jemi ftuar për të shikuar dosjen e tenderit që është shpallur fitues, më datën 03/04/2017. me ç'rast kemi pranuar edhe kopjen e një pjese të dosjes së tenderit fitues, sipas përcaktimit nga ana jonë.
Si palë e interesuar, ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit, pranë AK Policia e Kosovës, më 05/04/2017, në përputhje me dispozitat, rregulloret dhe afatet që rrjedhin nga LPP.

Më 14/04/2017, kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës së parashtruar për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 6. Paragrafi 1.** *Fondet dhe burimet publike të përdoren duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit;* meqenëse AK ka vendosë që tenderi t'i jepet konsorciumit i cili nuk ka dëshmuar qartë përputshmërinë me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe rrezikon të furnizojë artikuj të cilët nuk përmbushin qëllimin e prokurimit – **mbrojtjen e jetës së policëve.**

**Neni 7. Paragrafi 1. dhe paragrafi 2.** *Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi;* meqenëse AK ka shpallur fitues konsorciumin, duke u mbështetur në dokumente, vërtetësia e të cilëve është refuzuar nga Instituti, emrin e të cilit e mbajnë, si dhe dokumente, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit. Në këtë mënyrë, AK ka favorizuar konsorciumin.

**Neni 59. Paragrafi 4.** *Përputhshmëria e tenderit me të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit;* meqenëse tenderi i konsorciumit nuk plotëson **substancialisht** kërkesat formale administrative të specifikuara në dosjen e tenderit.

**Neni 60. Paragrafi 1. Pika 1.** *Tenderi i përgjegjshëm;* meqenëse AK ka vendosur që të shpallet fitues tenderi i cili NUK është i përgjegjshëm, por ka marr parasysh vetëm kriterin e çmimit më të ulët.

**Neni 64.** *Dëshmitë e kërkesave;* meqenëse AK ka vendosur që të shpallet fitues tenderi i cili NUK ka dëshmuar përshtatshmërinë profesionale.

**Neni 67.** *Provat shkresore;* meqenëse, përkundër vendimit të OSHP-së, AK fare nuk ka marrë parasysh provat e grumbulluara gjatë procesit të ri-vlerësimit. Në vend të kësaj, në kundërshtim me LPP, si dhe **në kundërshtim me vendimin e OSHP-së,** AK ka vendosur që të shpallet fitues tenderi i cili nuk ka sjellë certifikatat e kërkuara, për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

**Neni 69. Paragrafi 2. Pika 1.** *Dëshmi për livrimin e suksesshëm të furnizimeve, për një autoritet publik, ose blerës privat, në Kosovë, ose vend tjetër;* meqenëse aftësia profesionale e konsorciumit është vlerësuar në saje të dokumenteve të ofruara nga anëtari i konsorciumit (Seyntex SA). Gjatë ri-vlerësimit, komisioni ka pranuar shkresa që dëshmojnë se konsorciumi NUK KA BËRË furnizim të suksesshëm për një autoritet publik, e megjithatë, ka vendosur ta heshtë një fakt të tillë dhe të vendosë në kundërshtim me faktet e mbledhura, si dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së.

**Neni 69. Paragrafi 2. Pika 4.** *Mostrat e produktit, <u>përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen;</u>* meqenëse tenderi i konsorciumit

nuk përmbanë përshkrimin e duhur të produkteve që duhet të furnizohen, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme.
Nga të dhënat që komisioni i ri-vlerësimit ka grumbulluar, shihet qartë se konsorciumi kanë paraqitur të dhëna jo të sakta, dhe të cilat nuk janë siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme. E megjithatë, ky komision, ka vendosur që të shpallë fitues konsorciumin në fjalë, në kundërshtim të plotë me LPP-në, si dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e mëparshëm të OSHP-së.

**Neni 69. Paragrafi 2. Pika 5.** *Certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente:* meqenëse tenderi i konsorciumit nuk përmbanë certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente, që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve. Përkatësisht, certifikatat që gjenden në dosjen e tenderit të konsorciumit, nuk vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, ndërsa raportet e testeve balistike të cilat janë ofruar në tender, nuk ofrojnë të dhëna për modelet, të cilat tenderuesi synon t'i furnizojë.
Gjatë ri-vlerësimit, komisioni ka pranuar shkresa zyrtare nga Instituti TNO, që **hudhë poshtë** të gjitha pretendimet e konsorciumit, që janë dhënë në përshkrimin e produkteve që duhet të furnizohen.
Përveç kësaj, Instituti TNO ka mohuar vërtetësinë e disa dokumenteve, të cilat i ka ofruar konsorciumi në tenderin e tyre. Pra, komisioni ka vendosur të shpallë fitues konsorciumin, për të cilin, ka dyshime të bazuar se ka ofruar **dokumente të falsifikuara.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Autoriteti Kontraktues ka bërë këto shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik**

Fitues i këtij tenderi, është shpallur konsorciumi i përbërë nga All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k.
Ky konsorcium nuk i përmbush dispozitat e LPP-së, siç është përshkruar në pikën 6. më lartë, e siç do të sqarojmë në vijim.

**NENI 6. Paragrafi 1.** Duke vendosur që fitues i tenderit të shpallet konsorciumi i cili nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, AK ka bërë shkelje të kësaj dispozite, sepse, rrezikon që fondet publike dhe burimet publike, të mos përdoren në përputhje me qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
Qëllimi i këtij prokurimi është **mbrojtja e jetës dhe shëndetit të policëve.**
Lënda e prokurimit është **furnizimi me pajisje mbrojtëse jelekë anti-plumb, për të cilat duhet dëshmuar në mënyrë të sigurt, nga laboratoret e licencuara, se i plotësojnë specifikacionet teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit.**

KONSORCIUMI NUK KA OFRUAR KURRFARË CERTIFIKATE QË DËSHMON PËR SHKALLËN E MBROJTJES, NË NIVELIN E KËRKUAR NË DOSJEN E TENDERIT.

Pra, me vendimin e vetë, komisioni i ri-vlerësimit, ka bërë shkelje të dispozitave të Nenit 6. Paragrafi 1. i LPP-së, ka dështuar në zbatimin e vendimit të OSHP-së, me nr. 294-297/16, të datës 11/11/2016, por edhe **ka vënë në rrezik jetën e policëve**, të cilët pritet t'i veshin këto pajisje mbrojtëse dhe të përballen me rrezikun e qartë për jetën e tyre.

**Për më tepër detaje lidhur me këtë, shih më poshtë tek sqarimi lidhur me shkeljet e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 1.**

---

NENI 7. **Paragrafi 1. dhe 2.** kërkojnë që AK të trajtojë të gjithë OE në mënyrë të barabart dhe jo-diskriminuese.
Gjatë ri-vlerësimit, komisioni i AK-së ka pranuar shkresa nga Instituti TNO, në të cilat **hudhen poshtë** pretendimet e konsorciumit për certifikatat e mbrojtjes balistike, por, ka vendosur që këto dokumente **t'i heshtë dhe të mos i marr parasysh fare**. Me veprimet e veta, komisioni ri-vlerësues, ka bërë diskriminim në të mirë të konsorciumit, duke pranuar prej tyre, si të vërteta dhe të vlefshme, dokumente të cilët ose janë të pavlefshme, ose, vërtetësia e tyre është hudhur poshtë nga autoriteti, emrin e të cilit e mbajnë (Instituti TNO).
Me vendimin e vetë, komisioni i ri-vlerësimit, ka bërë shkelje të dispozitave të Nenit 7. Paragrafi 1. dhe 2. I LPP-së, si dhe ka dështuar në zbatimin e vendimit të OSHP-së, me nr. 294-297/16, të datës 11/11/2016, për trajtim të barabartë të të gjithë tenderuesve.

---

**NENI 59. Paragrafi 4.** Me vendimin e vet, komisioni ri-vlerësues ka bërë shkelje të kësaj dispozite, sepse, siç sqaron në detale dokumenti **A02 Udhëzues Operativ për Prokurim Publik**, botuar nga KRPP, në pikën 35. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 3. ku saktësohen **Parimet kryesore** të procedurës së vlerësimit sipas LPP:

1. **Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.**

2. **Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).**

3. **Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.**

Duke mos respektuar këto parime, komisioni ri-vlerësues ka bërë edhe shkelje të qartë të vendimit paraprak të OSHP-së, me të cilin OSHP ka **obliguar** AK-në që vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me këtë nen 59.

Vendimi i përmendur i OSHP-së ka **obliguar** AK-në që të kërkojë sqarime për të gjitha kërkesat në lidhje me certifikatat e kërkuara dhe raportet testuese laboratorike. Në procesin e ri-vlerësimit, komisioni i AK-së, nuk ka marrë parasysh shkresën e Institutit TNO, me të cilin, ky Institut, ka pranuar se ka lëshuar vetëm 3 dokumente të cilat i ka dorëzuar konsorciumi i shpallur fitues, ndërsa **ka hudhur poshtë** të gjithë dokumentet tjerë. Gjithashtu, Instituti TNO ka sqaruar se kanë lëshuar vetëm NJË CERTIFIKATË për mbrojtjen balistike, e jo katër, siç pretendohet nga konsorciumi i shpallur fitues.

Në këtë mënyrë pra, komisioni ri-vlerësues, ka pranuar dokumente, vërtetësia e të cilëve nuk është pranuar nga vetë Instituti TNO, emri i të cilit gjendet në këto dokumente.
Për më tepër, komisioni ri-vlerësues, ka pranuar si certifikata, dokumentet të cilat NUK JANË të tilla, duke vepruar edhe **kundër sqarimit nga Instituti TNO**, i cili ka lëshuar dokumentet e caktuara (të përmendura më poshtë).

---

**NENI 60. Paragrafi 1. Pika 1.** saktëson se Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e **PËRGJEGJSHËM** me çmimin më të ulët.
Duke vendosur që të shpallë fitues konsorciumin i cili nuk ka përmbushur substancialisht kërkesat formale; nuk ka përmbushur kërkesat minimale të kualifikimit; nuk ka përmbushur substancialisht kushtet obligative teknike, AK qartazi ka bërë shkelje të kësaj dispozite.

---

**NENI 64.** AK ka vendosur të shpallë fitues konsorciumin All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k. anëtarët e të cilit nuk kanë fare përvojë në këtë fushë. Kjo dëshmohet edhe nga lista e projekteve, të dorëzuara nga konsorciumi, në të cilën, shihen projekte të ndërtimit të lartë dhe ndërtimit të ultë dhe as edhe një projekt, që ka të bëjë me **sigurinë e jetës së policëve**. Për më tepër, konsorciumi ka dështuar të ofrojë **dëshmi shkresore** se plotëson kriteret kryesore të vlerësimit të tenderëve, qoftë ato formale, apo teknike.

---

**NENI 67.** Edhe pse në vendimin e OSHP-së është kërkuar që gjatë ri-vlerësimit, AK të vërtetojë provat shkresore, të dorëzuara nga konsorciumi, komisioni ri-vlerësues, ka vepruar **kundër** dëshmive të cilat i ka pranuar nga kompania GK Professional (shih më poshtë, sqarimin lidhur me shkeljet e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 1), si dhe dhe dëshmive të cilat i ka pranuar nga Instituti "TNO" (shih sqarimin më poshtë, lidhur me shkeljet e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 5.).

---

**NENI 69. Paragrafi 2. Pika 1.** Kriteri i aftësive teknike dhe/ose profesionale për tenderin fitues, është marrë si i vërtetuar, në saje të referencave të ofruara nga njëri anëtar i konsorciumit (Seyntex SA), kompani e huaj. Dokumentet të cilat konsorciumi i ka ofruar për të vërtetuar aftësitë teknike dhe/ose profesionale për tenderin fitues, janë deklarata të lëshuara nga anëtari i konsorciumit (Seyntex SA) për shitje të sasive të konsiderueshme të pajisjeve, për institucione zyrtare të Francës, Italisë, e shteteve tjera Evropiane. Mirëpo, tenderi i konsorciumit nuk përmbanë ASNJË REFERENCË, ose RAPORT TË PRANIMIT nga ndonjë përdorues i fundit.

Gjatë procesit të ri-vlerësimit, komisioni i AK-së, ka kontaktuar një kompani private, GK Professional, nga Franca dhe ka marrë prej tyre, një konfirmim, me email, sipas të cilit, kjo kompani, ka lëshuar referenca për kompaninë tjetër Seyntex SA, e cila është anëtare e konsorciumit.
Korrespondenca është kryer me Stephanie TALPE KUMUCHIAN, R&D and Purchasing Director, me email adresën: steph@gkpro.fr, më 07/12/2016.
Nga emaili, është e qartë se znj. Talpe Kumuchian, nuk përfaqëson asnjë autoritet publik në

Francë, por, përfaqëson një kompani private, pa kurrëfar autoriteti publik, siç kërkohet në dispozitat e LPP-së.

Megjithatë, komisioni, këtë konfirmim, e ka marrë si DËSHMI të mjaftueshme, sipas Nenit 69, Paragrafi 2, Pika 1, ndonëse, Ligji i Prokurimit Publik, është i qartë se: **kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë**

Kompania GK Professional, është PËRFAQËSUES i kompanisë Seyntex SA, kurse kjo e dyta është PRODHUES e këtyre pajisjeve. Në tekst të shkresave, GK Professional shprehet se artikujt janë furnizuar "PËRMES PARTNERIT TONË GK PROFESSIONAL".
Si ka kuptim që kompania ta quaj vet-veten PARTNER? Përmbajtja e këtyre shkresave, është e njëjtë me shkresat të cilat i kanë nënshkruar zyrtarët e kompanisë Seyntex SA, duke ndryshuar vetëm emërtimin e kompanisë.

Duke pasur parasysh këtë, është e qartë se këto shkresa janë përgatitur nga kompania Seyntex SA dhe vetëm janë nënshkruar nga kompania GK Professional, me çka bëhet i qartë edhe raporti në mes tyre dhe Seyntex SA.

Pra, siç shihet qartë edhe nga përmbajtja e këtyre shkresave, këto dy kompani, janë të lidhura në mes veti. Asnjë prej këtyre shkresave, nuk përmbanë dëshmi që mallrat janë pranuar nga ndonjë autoritet publik. Asnjë prej këtyre shkresave, nuk është **lëshuar**, ose **bashkënënshkruar** nga AUTORITETET PUBLIKE, të cilat pretendohet se janë pranues të produkteve.

Për ta bërë situatën më të qartë, duhet parë vetë punën e komisionit ri-vlerësues. Ky komision, ka hudhur poshtë të gjitha shkresat që janë lëshuar si referenca, nga kompania Seyntex S.A. me arsyetimin se NUK JANË DËSHMI PRANIMI NGA NJË AUTORITET PUBLIK.
Në vend se të njëjtin vendim ta marrë edhe për shkresat që janë lëshuar nga GK Professional, komisioni i ri-vlerësimit, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, si dhe ka dështuar në zbatimin e vendimit të OSHP-së, që kërkon vlerësimin e drejtë të të gjithë dokumenteve që gjenden në tender.

Për të sqaruar situatën më lehtë, do të sjellim një shembull krahasues. Kompania Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" (shkurtimisht "Katana") është PËRFAQËSUES i kompanisë Mehler Law Enforcement (shkurtimisht MLE), e cila është PRODHUES i jelekëve antiplumb. Në këtë tender, "Katana" ka dorëzuar fletëdërgesat e **bashkënënshkruara** nga zyrtarët e autoritetit publik, të cilët i kanë pranuar furnizimet.

Pra, nga ky shembull, shihet qartë se, komisioni ri-vlerësues, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, pasiqë, nga konsorciumi i përbërë nga All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k. ka pranuar shkresa të cilat prodhuesi dhe përfaqësuesi, i kanë lëshuar vet-vetit, e të cilat janë pa kurrëfar vlere ligjore për këtë procedurë tenderimi, ndërsa ka pasur shembullin e qartë nga kompania jonë se si duhet të veprohet, meqenëse ne kemi dorëzuar fletëdërgesa të cilat janë të bashkënënshkruara nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, si autoritet publik, që ka pranuar furnizimet.

Me veprimin e tillë, komisioni ri-vlerësues ka dështuar plotësisht në zbatimin e vendimit të OSHP-së, që kërkon trajtim të barabartë të të gjithë tendereusve.

**PRA, KONSORCIUMI ALL ZONE SH.P.K., SEYNTEX SA DHE PROCPM SH.P.K., NUK PLOTËSON DISPOZITAT E NENIT 69. PARAGRAFI 2. PIKA 1.**

---

**NENI 69. Paragrafi 2. Pika 4.** kërkon që operatorët ekonomik të dëshmojnë aftësitë e tyre teknike përmes *mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen*

Tenderi i konsorciumit fitues, në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit, **nuk ka ofruar specifikacionet teknike** të produkteve që do të furnizohen. Në vend të kësaj, shtylla e tretë e tabelës, e cila duhet të plotësohet me këto të dhëna, është përshkruar "copy-paste" me të dhënat nga shtylla e dytë, duke përfshirë edhe fotografitë e produkteve, që përbënë shkelje të përcaktimeve të dosjes së tenderit dhe LPP-së, sepse, as të dhënat e përshkruara e as fotografitë e paraqitura, **NUK PARAQESIN PRODUKTET QË GJENDEN NË MOSTRA.**

Në krye të tabelës që gjendet në Aneksin 1. qartë kërkohet që OE të bëjë përshkrimin e specifikacioneve teknike, duke përfshirë **brendin** dhe **modelin** e produkteve që do të furnizohen.

Gjatë procesit të ri-vlerësimit, komisioni vlerësues i AK-së, ka kontaktuar kompaninë All Zone, si udhëheqëse të konsorciumit, duke kërkuar sqarime lidhur me specifikacionet teknike, të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1. të dosjes së tenderit.
Kompania All Zone, më date 07/12/2016, ka lëshuar DEKLARATË PËR SPECIFIKACIONET TEKNIKE, përmes së cilës:

a) konfirmojnë se specifikacionet teknike të produkteve të ofruara, NË TËRËSI janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1. të dosjes së tenderit me nr. 216-16-134-111
b) konfirmojnë se produktet e liferuara, do të jenë sipas specifikacioneve teknike të ofruara dhe në tërësi në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1. të dosjes së tenderit me nr. 216-16-134-111

Megjithatë, në tenderin e konsorciumit, është shënuar vetëm brendi **Seyntex**, pa përcaktuar fare modelin që do të furnizohet.
Pra, konsorciumi i shpallur fitues, me vetëdije, ka bërë deklaratë të papranueshme.

Konsorciumi ka dorëzuar edhe një katalog të produkteve, por, ky katalog nuk mundet të merret parasysh, sepse, në Aneksin 1. nuk është specifikuar fare me cilët modele ka ofertuar konsorciumi.
As deklarata të cilën e ka lëshuar prodhuesi Seyntex SA, përmes z. Martin Vanonvenberghe, International Sales Director, më datë 07/12/2016 lidhur me peshën e jelekut të jashtëm (Overt vest), nuk përmendë kurrfarë modeli të saktë, e as nuk konfirmon se ky jelek, është në përputhje me specifikat e kërkuara në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit.

Kjo mospërputhje vëhet në shprehje sidomos kur merren parasysh mospërputhjet e mëdha në dokumentet që konsorciumi ka ofruar si dëshmi për mbrojtjen balistike dhe për mbrojtje kundër therrjes.

Si rrjedhojë, është e pamundur që tenderi në fjalë të pranohet si i përgjegjshëm, për shkak se në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit nuk ka përshkruar fare produktet me të cilat ka ofertuar. Pra, nuk dihet fare ÇFARË MODELI KA OFERTUAR konsorciumi.

**Si përfundim, deklarata e sipërpërmendur nga udhëheqësi i konsorciumit, është e papranueshme dhe si rrjedhojë, KONSORCIUMI ALL ZONE SH.P.K., SEYNTEX SA DHE PROCPM SH.P.K., NUK PLOTËSON DISPOZITAT E NENIT 69. PARAGRAFI 2. PIKA 4.**

---

**NENI 69. Paragrafi 2. Pika 5.** kërkon që operatorët ekonomik të dëshmojnë aftësitë e tyre teknike *përmes certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara*, që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, **QË QARTAZI MUND TË IDENTIFIKOHEN**, duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.

Në Dosje të Tenderit, Seksioni 2. **Fleta e të Dhënave të Tenderit, paragrafi 9.2,** si dhe në **Aneksi 1. Specifikacionet Teknike**, lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë parashtruar këto kërkesa:
4. Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IV (4) – kopje
5. Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) – kopje
6. Certifikatë për nivelin e mbrojtjes min KR1- kopje

Tenderi i konsorciumit fitues nuk përmbanë **asnjë certifikatë,** si dëshmi për plotësimin e kritereve për nivelin e mbrojtjes NIJ-IIIA, NIJ-IV dhe KR-1, të cilat **QARTAZI MUNDË TË IDENTIFIKOHEN**, duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.

Gjatë procesit të ri-vlerësimit, komisioni i AK-së ka kontaktuar Institutin TNO në Holandë. Përgjigja është pranuar me email, nga Hans Bakker, Project Coordinator, me email adresë: h.bakker@tno.nl, më 25/11/2016.

Në këtë email, z. Bakker, ka konfirmuar se Instituti TNO, ka lëshuar raportet e testit, me nr. 07MB04750 dhe 07MB04751, si dhe ka konfirmuar se Instituti TNO, ka lëshuar certifikatën e përputhshmërisë me referencë 15LBR/1597.
Në këtë email, z. Bakker, ka konfirmuar se ky institut, NUK KA LËSHUAR asnjë nga dokumentet tjerë.
Kjo do të thotë se, komisioni i ri-vlerësimit, ka dështuar në zbatimin e vendimit të OSHP-së, me nr. 294-297/16 të datës 11/11/2016, sepse, edhe pse përmes këtij emaili, u është bërë e qartë se, një numër i dokumenteve, të cilët gjenden në tenderin e konsorciumit, nuk janë lëshuar nga Instituti, emrin e të cilit e mbajnë, komisioni ka vazhduar këto dokumente t'i trajtojë si të vlefshme.

Për më tepër, ndonëse në këtë email, z. Bakker ka konfiruar vërtetësinë e disa dokumenteve, ai në asnjë mënyrë nuk ka konfirmuar se këto raporte të testeve, apo certifikata e

përputhshmërisë, i referohen jelekëve anti-plumb, të cilët janë kërkuar në specifikacionet teknike të këtij tenderi.
Pra, Instituti TNO, në asnjë mënyrë, nuk ka mbështetur përputhshmërinë e tenderit të konsorciumit, me kërkesat e AK-së.

TENDERI I KONSORCIUMIT KA OFRUAR NJË VARG DOKUMENTESH SI DËSHMI PËR TESTET E KRYERA, POR, KËTO DOKUMENTE NUK MUNDË TË MERREN PARASYSH, SEPSE, KËTO DOKUMENTE, OSE JANË HEDHUR POSHTË NGA INSTITUTI "TNO", OSE "TNO" KA VËRTETUAR SE ATO NUK JANË TË PËRDORSHME PËR QËLLIME TË KËTIJ TENDERI.

Meqenëse Aneksi 1. i tenderit të konsorciumit nuk përmbanë të dhëna mbi modelin e ofruar, është e pamundur që këto certifikata dhe teste të pranohen si të vlefshme, sepse Instituti TNO nuk ka dhënë kurrfarë konfirmimi se ato teste, në fakt i referohen produkteve që kanë të bëjnë me këtë tender (shih në vijim).

Raportet e testit, me nr. 07MB04750 dhe 07MB04751, janë *raport i testimit* dhe nuk mundë të konsiderohet si *certifikatë e përputhshmërisë*. Në secilën faqe të këtyre dokumenteve, në këndin e majt-poshtë, gjendet shënimi që parandalon një veprim të tillë (**this test certificate can not be used as product certification**). Kjo konfirmohet edhe nga emaili të cilin AK e ka pranuar nga Instituti "TNO", në të cilin qartë thuhet se këto dokumente janë RAPORTE TË TESTIMIT.

Për të sqaruar më tutje shkeljet që kanë ndodhur lidhur me këto dokumente, duhet sqaruar përbërjen dhe funksionimin e jelekëve anti-plumb.
Në këtë tender, janë kërkuar dy lloje të këtyre pajisjeve mbrojtëse. Njëri lloj, janë jelekët e "brendshëm" (Covert Vest) dhe tjetri janë jelekët e "jashtëm" (Overt Vest). Fjalët "Covert" dhe "Overt" nuk janë emërtime të modeleve, por janë kuptimi në verzionin anglisht, i fjalëve shqipe.

Ndonëse ofrojnë nivel të njëjtë të mbrojtjes (NIJ-IIIA), lloji i parë, janë të ndërtuar ashtu që të mundë të barten NËN uniformën policore, kurse lloji i dytë, barten MBI uniformë. Përpos kësaj, jelekët e "jashtëm" kanë edhe pllakë keramike, e cila e shtonë nivelin e mbrojtjes, nga NIJ-IIIA (mbrojtja kundër pistoletave), në NIJ-IV (mbrojtja kundër armëve të gjata, duke përfshirë edhe pushkën AK-47 Kallashnikov).
Pra, ndërtimi i tyre është i ndryshëm, prandaj, edhe testet dhe certifikatat që lëshohen për cilësinë e tyre, janë të ndryshme. D.m.th. certifikatat që dëshmojnë për nivelin e mbrojtjes NIJ-IIIA të jelekut të "brendshëm", nuk mundë të përdoren për të dëshmuar nivelin e mbrojtjes NIJ-IIIA të jelekut të "jashtëm".

Për të sqaruar më thjeshtë këtë çështje, do të japim një shembull krahasimor. Scan Color prodhon ngjyra të ndryshme për dru e metale. Ngjyrat e "brendshme", përdoren për lyerje të metaleve të cilat do të qëndrojnë brenda shtëpisë. Këto ngjyra, nuk munden të përdoren për lyerje të "jashtme", d.m.th. të produkteve metalike të cilat do të qëndrojnë në oborr, sepse, do t'i zë ndryshku. Për të parandaluar ndryshkun, këto metale, duhet të lyhen me "parangjyrë", e cila brenda periudhës së garancionit, parandalon kontaktin e lagështisë me hekurin. Për më tepër, ngjyrat e "jashtme" duhet të përputhen me "parangjyrën", përkatësisht, nuk do të duhet të përdoren ngjyrat e drurit në metal.

Prandaj, edhe certifikatat e cilësisë për secilin lloj të ngjyrës, dallojnë, sepse, kushtet atmosferike, të cilave u nënshtrohen dy llojet e ngjyrave, janë të ndryshme. P.sh. certifikatat e cilësisë për ngjyrën e jashtme metalike, do të vlejnë vetëm kur kjo ngjyrë, do të përdoret me parangjyrën përkatëse, e jo nëse vendoset drejtpëdrejt në metal, i cili do të qëndrojë nëpër oborr. Aq më tepër, garancioni nuk do të vlejë, nëse metali është lyer me ngjyrë "druri", qoftë edhe nëse është kombinuar me "parangjyrë".

Ngjashëm me këtë shembull, pllakat e keramikës, që ofrojnë mbrojtje balistike të nivelit NIJ-IV, do të kombinohen me jelekun e "jashtëm", të nivelit NIJ-IIIA, e jo të përdoren të vetme.
Gjithashtu, certifikatat e mbrojtjes balistike për jelekët e "jashtëm" nuk do të jenë të vlefshme për jelekët e "brendshëm".

Nga ky përshkrim i thjeshtë, bëhet e qartë rëndësia pse dosja e tenderit, NË MËNYRË TË QARTË, kërkon që, tenderuesi të përshkruaj **brendin** dhe **modelin** e jelekëtve anti-plumb, të cilët i ofertón. Pa këto informata, asnjë person, nuk mundet të bëjë vlerësimin e duhur të tenderit dhe nuk mundet të konfirmojë se tenderi në fjalë, përmbushë kërkesat e dispozitave të LPP-së, nga Neni 69, Paragrafi 2, Pika 4. **Çfarëdo vendimi ndryshe, do të vë në rrezik jetën e policëve.**

Lidhur me certifikimin për nivelin NIJ-IV të mbrojtjes balistike, në tenderin e konsorciumit gjenden një numër i raporteve të testeve të kryer, që i referohen pllakave balistike, me shënimin e modelit **SHB-IV-3 së bashku me jelekun me mbrojtje të butë NIJ 3A.**
Në fund të faqes, të gjitha këto raporte, kanë shënimin se **NUK MUNDË TË PËRDOREN PËR CERTIFIKIM TË PRODUKTEVE.**

Gjithashtu, gjatë procedurës së ri-vlerësimit, komisioni ri-vlerësues ka kërkuar nga Instituti TNO, emri i të cilit gjendet në këto dokumente, që t'i konfirmojë ato.
Ky Institut, ka konfirmuar se, dokumentet me nr. 07MB04750 dhe 07MB04751, janë raporte të testeve, e NUK JANË Certifikatë e Përputhshmërisë, duke vërtetuar thënien tonë, të mësipërme. E megjithatë, komisioni ri-vlerësues, ka vendosur që këto dokumente t'i pranojë si certifikata, në kundërshtim me të gjitha provat e shrkesave dhe në kundërshtim me qëndrimin e vetë autoritetit, i cili i ka lëshuar dokumentet. Në këtë mënyrë, komisioni ri-vlerësues ka vepruar edhe në kundërshtim me vendimin paraprak të OSHP-së.

Për më tepër, në tenderin e konsorciumit, modeli SHB-IV-3 **nuk përmendet askund**. Pra, duke iu referuar shembullit me ngjyra, askush nuk mundet të dijë me çfarë ngjyre do të lyhet metali, ndonëse dihet që, ai metal do të qëndrojë "jashtë".
Kur kihet parasysh se, në kushtet e policëve, jelekët e "jashtëm" do të përdoren në kushte të rrezikut të qartë për jetën e tyre (mundë të ballafaqohen me sulm me armë të gjata, duke përfshirë edhe pushkën AK-47 Kallashnikov), është e qartë se, pa këto informata, cilido polic që do të vesh një jelek të tillë, do të vendosë jetën e vet në rrezik serioz.

Siç u përmend, këto teste janë kryer në jelekun e jashtëm (Overt vest), së bashku me pllakat mbrojtëse. Pra, modeli që përmendet në këto dokumente, duhet të jetë i njëjti me modelin që përmendet në raportet e testeve balistike për nivelin e mbrojtjes NIJ-IIIA, të jelekut të jashtëm.
Ose, sipas shembullit të ngjyrave -- modeli i "parangjyrës" duhet të përputhet me modelin e ngjyrës së "jashtme" për metale (pra, jo të brendshme dhe jo për dru).

Megjithatë, modeli SHB-IV-3, i përmendur në këto raporte, nuk përputhet me të dhënat e testimit për mbrojtjen balistike NIJ III-A, për jelekun e jashtëm (Overt vest) të cilat i referohen produktit Seyntex Model Var 1 dhe produktit ABL/Belgie.

PRA, TENDERI I KONSORCIUMIT NUK PËRMBANË DËSHMI PËR CERTIFIKIMIN E PLLAKAVE SIPAS STANDARDIT NIJ 0101.04 TË NIVELIT IV, QË ËSHTË NDËR KRITERET THEMELORE PËR DËSHMITË E SHKRESAVE.

Pra, tenderi i konsorciumit, nuk plotëson pikën 4. në Dosje të Tenderit, Seksioni 2. **Fleta e të Dhënave të Tenderit, paragrafi 9.2,** si dhe në **Aneksi 1. Specifikacionet Teknike,** lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale: **Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IV (4) – kopje**

RRJEDHIMISHT, KËTO PLLAKA, **NUK GUXOJNË,** NË ASNJË MËNYRË TË PËRDOREN NGA POLICIA E KOSOVËS.

.....

Lidhur me certifikimin për nivelin III-A të mbrojtjes balistike, një numër i raporteve, i referohen modelit **Compositie – A Front & Compositie – A Back**: disa të tjera, i referohen modelit **Composition A Front** dhe **Composition A Back**: disa të tjera, i referohen modelit **ABL/Belgie**. MODELI ABL/BELGIE I REFEROHET **DISA VERZIONEVE**, NDONËSE, NË DOSJEN E TENDERIT ËSHTË PËRCAKTUAR SE ***VERZIONET NUK DO TË LEJOHEN***. Këto raporte, përmbajnë edhe të dhëna për testet e kryer për pjesën e ijeve ("groin"), që është shtesë, që përdoret për modelet e jelekut "taktik" që **nuk është model, i cili është kërkuar në specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit.**

Është e qartë se, sikur edhe në këtë rast, vlejnë të njëjtat shkelje, sikur për mbrojtjen balistike NIJ-IV. Nga të dhënat që gjenden në tenderin e konsorciumit, askush nuk mundet të vërtetojë se me çfarë modeli është ofertuar, e as të vërtetojë se këto dokumente vlejnë për këtë tender. Duke marrë nga shembulli i ngjyrave – nuk është e qartë nëse tenderi ofron ngjyrë metali apo druri, e as që dihet nëse këto ngjyra mundë të përdoren jashtë, apo brenda.

TENDERI I KONSORCIUMIT NUK PËRMBANË DËSHMI PËR CERTIFIKIMIN E JELEKËVE,SIPAS STANDARDIT NIJ 0101.04 TË NIVELIT III-A.
Pra, tenderi i konsorciumit, nuk plotëson pikën 5. në Dosje të Tenderit, Seksioni 2. **Fleta e të Dhënave të Tenderit, paragrafi 9.2,** si dhe në **Aneksi 1. Specifikacionet Teknike,** lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale: **Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) – kopje**

RRJEDHIMISHT, KËTA JELEKË, **NUK GUXOJNË,** NË ASNJË MËNYRË TË PËRDOREN NGA POLICIA E KOSOVËS.

.....

Lidhur me certfikimin për mbrojtje nga therrja (KR1), raporti i testit është lëshuar nga një laborator tjetër, dhe i referohet modelit **VAR 5**, i cili nuk përputhet me modelet e përmendura më sipër për mbrojtje balistike, e as që është i përmendur diku në dosjen e tenderit të konsorciumit.
Mbrojtja kundër therrjes (KR1) i shtohet jelekëve anti-plumb të "brendshëm", pra, edhe modeli i përmendur në këto teste, duhet të jetë i njëjti, sikur ai që përmendet në testet e mbrojtjes balistike të nivelit NIJ-IIIA. Megjithatë, nga sa u tha më sipër, është e qartë se, kjo nuk qëndron.

Si rrjedhojë, është e pamundur që tenderi në fjalë të pranohet si i përgjegjshëm, përkatësisht, është e pamundur që këto raporte të testeve balistike, të pranohen si dëshmi të cilat **QARTAZI MUNDË TË IDENTIFIKOHEN** për shkak se – modelet të cilat përmenden në këto raporte, nuk janë përmendur fare në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit, si dhe për shkak se, këto modele, fare nuk janë në përputhje në mes vete.

TENDERI I KONSORCIUMIT NUK PËRMBANË DËSHMI PËR CERTIFIKIMIN E JELEKËVE, PËR MBROJTJE KUNDËR THERRJES.

Pra, tenderi i konsorciumit, nuk plotëson pikën 6. në Dosje të Tenderit, Seksioni 2. **Fleta e të Dhënave të Tenderit, paragrafi 9.2,** si dhe në **Aneksi 1. Specifikacionet Teknike**, lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale: **Certifikatë për nivelin e mbrojtjes min KR1- kopje**

RRJEDHIMISHT, KËTA JELEKË, **NUK GUXOJNË,** NË ASNJË MËNYRË TË PËRDOREN NGA POLICIA E KOSOVËS.

**Në përfundim, është e qartë se komisioni ri-vlerësues i AK-së, ka bërë shkelje të shumta të dispozitave të LPP-së, duke pranuar si të vërteta dokumente, vërtetësia e të cilave është hudhur poshtë nga laboratori TNO (pra, munden të jenë edhe të falsifikuara), duke i pranuar ato dokumente në kundërshtim me përcaktimin që atyre ua ka dhënë vetë autoriteti i cili i ka lëshuar, si dhe ka dështuar në zbatimin e vendimit të OSHP-së me nr. 294-297/16 të datës 11/11/2016.**

Të gjitha këto i janë bërë me dije AK-së në kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit në AK. Megjithatë, në vendimin e tyre për refuzim të kërkesës sonë, AK nuk ka trajtuar asnjërën nga këto pretendime.

Në asnjë fazë të procesit të ri-vlerësimit, e as në vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim, nuk janë konstatuar parametrat themelor, për shpalljen e tenderit të suksesshëm, siç është kërkuar në vendimin e OSHP-së, me nr. 294-297/16:

- Modeli me të cilin ka aplikuar konsorciumi All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k. për jelek anti-plumb të brendshëm;
- Modeli me të cilin ka aplikuar konsorciumi All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k. për jelek anti-plumb të jashtëm;
- Përshkrimin e produkteve që ofrohen, e që QARTAZI MUNDË TË IDENTIFIKOHEN;
- Dëshmitë për furnizim të suksesshëm për një autoritet publik në Kosovë, ose vend tjetër – së paku dy projekte, në tri vitet e fundit;
- Listën e projekteve të ngjashme;
- Certifikata për mbrojtje balistike të nivelit NIJ-IIIA;
- Certifikata për mbrojtje balistike të nivelit NIJ-IV;
- Certifikata për mbrojtje kundër therrjes KR1;
- Raportet e testit balistik për mbrojtje të nivelit NIJ-IIIA;
- Raportet e testit balistik për mbrojtje të nivelit NIJ-IV.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP, që të caktojë një ekspert, i cili do të jetë në gjendje t'i trajtojë si duhet të gjitha këto pretendime dhe të nxjerrë përfundim të qartë për secilin prej tyre.

Në këtë mënyrë, OSHP do të ketë fare të lehtë të marr vendimin e duhur, përkatësisht, të shpallë të pasuksesshëm tenderin e konsorciumit All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k.

Aneks lidhur me paragrafin 8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Në vijim, në mënyrë të detajuar, janë paraqitur mospërputhjet dhe shkeljet e kryera nga komisioni i ri-vlerësimit, lidhur me dokumentet që gjenden në tenderin e konsorciumit, i cili është shpallur fitues i këtij tenderi.*

| DOSJA E KONSORCIUMIT ALL ZONE, SEYNTEX S.A. dhe PROCPM sh.p.k. | | |
|---|---|---|
| Nr. | Dokumenti | Pse nuk është i vlefshëm |
| 1 | Reference letter for supply of ballistic vests<br>GK Professional for end delivery to Police Forces of France | Ky dokument është lëshuar (nënshkruar dhe vulosur) nga kompania frenge GK Professional, që është përfaqësues i anëtarit të konsorciumit N.V. Seyntex S.A. dhe nuk përmban kurrfarë dëshmie nga pranuesi i mallit (përdoruesi i fundit/klienti), d.m.th. autoriteti përkatës i Policisë së Francës |
| 2 | Reference letter for supply of ballistic vests<br>GK Professional for end delivery to Prisons France | Ky dokument është lëshuar (nënshkruar dhe vulosur) nga kompania frenge GK Professional, që është përfaqësues i anëtarit të konsorciumit N.V. Seyntex S.A. dhe nuk përmban kurrfarë dëshmie nga pranuesi i mallit (përdoruesi i fundit/klienti), d.m.th. autoriteti përkatës i burgjeve në Francë |
| 3 | References of rucksacks and load carrying equipment<br>Ministry of Defence France | Ky dokument është lëshuar (nënshkruar dhe vulosur) nga anëtari i konsorciumit N.V. Seyntex S.A. dhe nuk përmban kurrfarë dëshmie nga pranuesi i mallit (përdoruesi i fundit/klienti), d.m.th. Ministria e Mbrojtjes e Francës |
| 4 | Reference production combat clothing<br>Ministry of Defence Denmark | Ky dokument është lëshuar (nënshkruar dhe vulosur) nga anëtari i konsorciumit N.V. Seyntex S.A. dhe nuk përmban kurrfarë dëshmie nga pranuesi i mallit (përdoruesi i fundit/klienti), d.m.th. Ministria e Mbrojtjes e Danimarkës |
| 5 | Letrat tjera të këtij lloji:<br>Ministry of Defence United Kingdom<br>Ministry of Defence the Netherlands<br>Loomis Securitas France | Këto dokumente janë lëshuar (nënshkruar dhe vulosur) nga anëtari i konsorciumit N.V. Seyntex S.A. dhe nuk përmbajnë kurrfarë dëshmie nga pranuesi i mallit (përdoruesi i fundit/klienti) |
| 6 | Lista e projekteve të realizuara, e ofruar nga anëtari i konsorciumit All Zone | Në këtë listë janë shënuar një varg projektesh që nuk kanë të bëjnë asgjë me natyrën e këtij tenderi. |
| **Si përfundim – konsorciumi i All Zone, nuk ka ofruar asnjë dëshmi (referencë, ose raport të pranimit) për dorëzimin me sukses të produkteve të veta. D.m.th. nuk është plotësuar kushti i paraparë në FDT paragrafi 9.2.7 ku kërkohet dëshmi e pranimit të produkteve nga ana e përdoruesit të fundit.** Pra, është bërë shkelje e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 1 | | |

| | | |
|---|---|---|
| 7 | Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme<br><br>Shkelje e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 4 | Tabela e dorëzuar nga konsorciumi, nuk përmbanë të dhëna për modelet e ofruara, as për specifikat me të cilat ka tenderuar konsorciumi. Në vend të kësaj, tabela është bërë Copy-Paste dhe përmbanë përshkrimin e të dhënave të përgjithshme, të cilat janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.<br>Në fotot e paraqitura në tabelën e konsorciumit, gjenden produkte të cilat nuk janë prodhim i Seyntex.<br>Në ueb-faqen e prodhuesit Seyntex nuk mundë të gjenden kurrfarë të dhëna për produktet e ngjashme me ato të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit.<br>Pra, konsorciumi NUK KA OFRUAR KURRFARË MODELI TË CAKTUAR për këtë tender, përkundër faktit se në krye të tabelës që gjendet në Aneksi 1. qartë kërkohet që OE të bëjë përshkrimin e specifikacioneve teknike, duke përfshirë **brendin** dhe **modelin** e produkteve që do të furnizohen.<br><br>Konsorciumi ka dorëzuar një katalog të produkteve, por, ky katalog nuk mundet të merret parasysh, sepse, në Aneksin 1. nuk është specifikuar fare me cilët modele ka ofertuar konsorciumi.<br>Kjo mospërputhje vëhet në shprehje sidomos kur merren parasysh mospërputhjet e mëdha në dokumentet që konsorciumi ka ofruar si dëshmi për mbrojtjen balistike dhe për mbrojtje kundër therrjes. |
| 8 | Certificate of Conformity e lëshuar nga National Technical Systems Inc. – Wichita Division për NIJ 0115.00 standard level KR1 special with S1/G knife<br>Si dhe<br>Abbreviated N.I.J. 0115.00 Stab Resistance Test (Record No: SETS15026-1 dhe SETS15026-2)<br><br>Standardi për mbrojtje ndaj therrjes që është kërkuar në dosje të tenderit, për jelekun e brendshëm (Covert vest) | Certifikata në fjalë dhe rezultatet e testeve që janë bashkëngjitur me të, janë lëshuar për produktin Seyntex Model Var 5 ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Këto teste janë kryer në jelekun e brendshëm (Covert vest). Pra, modeli duhet të jetë i njëjti sikur në pikën 13. dhe 14. më poshtë, sepse i njëjti jelek (Covert vest) duhet të ofrojë edhe mbrojtje kundër therrjes edhe mbrojtje balistike III-A.<br>Certifikata në fjalë dhe rezultatet e testeve që janë bashkëngjitur me të, janë lëshuar për produktin Seyntex Model Var 5 ndërsa dokumentet që janë dorëzuar si dëshmi për plotësimin e kushteve për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, për jelekun e brendshëm (Covert vest), i referohen produktit Compositie A (shih pikën 14.) |

| | | |
|---|---|---|
| **Duke pasur parasysh se kjo certifikatë është lëshuar nga një institut i ndryshëm nga ai që ka lëshuar certifikatat dhe raportet e testeve në pikën 14. është e qartë se këto certifikata nuk i referohen të njëjtit model. Prandaj, kjo certifikatë nuk mundë të konsiderohet si e vlefshme.**<br>Është bërë shkelje e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 5. | | |
| 9 | BALLISTIC LABORATORY REPORT NIJ 0101.04 level IV<br>Tested ICW soft armor<br><br>Fletë përcjellëse për raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ IV për jelekun e jashtëm (Overt vest) | Kjo fletë përcjellëse i referohet produktit Seyntex Model Var 18 ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Kjo fletë përcjellëse është bashkëngjitur me raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ-IV (pllakat së bashku me jelekun) që gjenden në numrin rendor 10. E këto raporte, i referohen produktit SHB-IV-3, që nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse. |
| 10 | Test certificate NIJ 0101.04 class IV, për katër pllaka<br>Reference 07MB04750 (3 faqe)<br>Reference 07MB04751 (3 faqe)<br><br>Reference 07MB04752 (3 faqe)<br>Reference 07MB04753 (3 faqe)<br>**Vërtetësia e dy dokumenteve të fundit, nuk është pranuar nga Instituti TNO.**<br><br>Raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ IV për jelekun e jashtëm (Overt vest). | Këto dokumente janë *raport i testimit* dhe nuk mundë të konsiderohet si *certifikatë e përputhshmërisë*. Në secilën faqe të këtyre dokumenteve, në këndin e majt-poshtë, gjendet shënimi që parandalon një veprim të tillë (**this test certificate can not be used as product certification**).<br><br>Këto dokumente i referohen produktit SHB-IV-3, që nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse (shih pikën 9.)<br><br>Këto dokumente i referohen produktit SHB-IV-3, ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Këto teste janë kryer në jelekun e jashtëm (Overt vest) së bashku me pllakat mbrojtëse. Pra, modeli duhet të jetë i njëjti sikur në pikën 11. dhe 12. më poshtë. Këto dokumente i referohen produktit SHB-IV-3, që nuk përputhet me të dhënat e testimit për mbrojtjen balistike NIJ III-A, për jelekun e jashtëm (Overt vest) të cilat i referohen produktit Seyntex Model Var 1 dhe produktit ABL/Belgie (shih pikat 11. dhe 12. më poshtë). |
| **Si përfundim, konsorciumi nuk ka dorëzuar dokumentin e kërkuar CERTIFIKATË për të dëshmuar mbrojtjen balistike NIJ-IV, pasiqë institucioni që ka lëshuar këto dokumente, ka shënuar klauzolën që këto dokumente nuk munden të përdoren për certifikim të produktit.** Neni 69. Paragrafi 2. Pika 5.<br>**Dokumentet që konsorciumi i ka dorëzuar si raporte të testeve për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ-IV, janë në shpërputhje të plotë në mes vete dhe me dokumentet që konsorciumi i ka dorëzuar si certifikata dhe raporte të testeve për mbrojtje balistike të** | | |

| | | |
|---|---|---|
| **nivelit NIJ III-A, për modelin e njëjtë (jeleku i jashtëm – Overt vest) dhe prandaj, nuk mundë të konsiderohen të vlefshme.**<br>Është bërë shkelje e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 5. | | |
| 11 | Ballistic Report (Seyntex Model Var 1)<br><br>Fletë përcjellëse për raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, për jelekun e jashtëm (Overt vest) | Kjo fletë përcjellëse i referohet produktit Seyntex Model Var 1 ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Kjo fletë përcjellëse është bashkëngjitur me raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ-IIIA, për jelekun e jashtëm (Overt vest) që gjenden në numrin rendor 12. E këto raporte, i referohen produktit ABL/Belgie, që nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse. |
| 12 | Certificate of Conformity, Reference 15 LBR/1596<br>NIJ 0101.04<br>Stanag 2920<br><br>Certifikata për plotësimin e kushteve për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, për jelekun e jashtëm (Overt vest) | Kjo certifikatë **nuk përmbanë emrin e modelit për të cilin është lëshuar**, që dallon nga certifikata me Reference 15 LBR/1597<br><br>Kjo certifikatë u referohet raporteve të testimit me nr. reference:<br>12MB01974 DERI 12MB01983; 12MB01969 DERI 12MB01971; 12MB01985 DERI 12MB01992; 12MB01633<br><br>Këto raporte të testimit, i referohen produktit ABL / Belgie, që nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse (shih pikën 11).<br><br>Këto raporte të testimit i referohen produktit ABL / Belgie, ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Këto raporte të testimit i referohen produktit ABL/Belgie, që nuk përputhet me të dhënat e testimit për mbrojtjen balistike NIJ IV, të cilat i referohen produktit SHB-IV-3 (shih pikat 9. dhe 10.) |
| **Si përfundim, dokumentet që konsorciumi i ka dorëzuar si dëshmi për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, janë në shpërputhje të plotë në mes vete dhe me dokumentet që konsorciumi i ka dorëzuar si dëshmi për mbrojtje balistike të nivelit NIJ IV, për modelin e njëjtë (jeleku i jashtëm – Overt vest) dhe prandaj, nuk mundë të konsiderohen të vlefshme.**<br>Është bërë shkelje e Nenit 69. Paragrafi 2. Pika 5. | | |

| | | |
|---|---|---|
| 13 | Ballistic Report (Seyntex Model Var 5)<br><br>Fletë përcjellëse për raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, për jelekun e brendshëm (Covert vest) | Kjo fletë përcjellëse i referohet produktit Seyntex Model Var 5 ndërsa në tenderin e konsorciumit, ky model nuk përmendet askund.<br><br>Kjo fletë përcjellëse është bashkëngjitur me raportet e testimit për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ-IIIA, për jelekun e brendshëm (Covert vest) që gjenden në numrin rendor 14. E këto raporte, i referohen produktit Compositie A, që nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse. |
| 14 | Certificate of Conformity, Reference 15 LBR/1597<br>NIJ 0101.04<br>Stanag 2920<br><br>Certifikata për plotësimin e kushteve për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, për jelekun e brendshëm (Covert vest) | Kjo certifikatë përmbanë emrin e modelit të cilit i referohet: NIJ level IIIA Composition A<br><br>Kjo certifikatë u referohet raporteve të testimit me nr. reference:<br>14MB02709; 14MB02710; 14MB02711; 14MB02712; 14MB02839; 14MB02840; 14MB03126; 14MB03127; 14MB03128; 14MB03129; 14MB03130; 14MB03131<br><br>Disa nga këto raporte të testimit, i referohen produktit Compositie A, e disa i referohen produktit Composition A, e që asnjëri nuk përputhet me të dhënat në fletën përcjellëse (shih pikën 13).<br><br>Disa nga këto raporte të testimit, i referohen produktit Compositie A, e disa i referohen produktit Composition A, ndërsa në tenderin e konsorciumit, asnjëri nga këto modele nuk përmendet askund.<br><br>Disa nga këto raporte të testimit, i referohen produktit Compositie A, e disa i referohen produktit Composition A, që nuk përputhet me të dhënat e testimit për mbrojtjen kundër therrjes, të cilat i referohen produktit Seyntex Model Var 5 (shih pikën 8.)<br><br>Këto raporte përmbajnë edhe të dhëna për testet e kryer për pjesën e ijeve ("groin"), që është shtesë që përdoret për modelet e jelekut "taktik" (të jashtëm), që nuk është model i cili është kërkuar në specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit. |

**Si përfundim, dokumentet që konsorciumi i ka dorëzuar si dëshmi për mbrojtjen balistike të nivelit NIJ III-A, janë në shpërputhje të plotë në mes vete dhe me dokumentet** që konsorciumi i ka dorëzuar si dëshmi për mbrojtje kundër therrjes KR-1 **për modelin e njëjtë (jeleku i brendshëm – Covert vest) dhe prandaj, nuk mundë të konsiderohen të vlefshme.**
Është bërë shkelje e Nenit 69, Paragrafi 2, Pika 5.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Nga kjo parashtresë, është e qartë se grupi i operatorëve ekonomik All Zone sh.p.k., Seyntex SA dhe PROCPM sh.p.k. nuk i plotësojnë kërkesat ligjore dhe si të tillë, është dashur të eliminohen.
Me vendimin e vetë, AK kanoset të shkaktojë dëme të konsiderueshme materiale, për shkak të fitimit të humbur.
Gjithashtu, ne si palë e interesuar, deri tani, kemi pasur shpenzime të panevojshme lidhur me këtë ankesë, për shkak të angazhimit të personelit shtesë për grumbullimin e informatave për tenderuesit e tjerë, si dhe për konsulencën profesionale, lidhur me hartimin e kësaj ankese.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht nje kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*